



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION



Intervistë e Ministrit Sadri Ferati

Për "Infopress" flet Sadri Ferati, ministër i Pushtetit Lokal

Prishtina, me disa komuna

- Ligjin për qytetin e Prishtinës e kemi proceduar në agjendën legjislative për vitin 2008
- Do të jetë e drejtë e qytetit të Prishtinës që të organizohet në më shumë se një komunë, në dy, tri apo aq sa është e domosdoshme

10 shkurt 2007

Kryeqyteti i Kosovës pritet që gjatë këtij viti ta ketë ligjin e vet, ndërsa një ligj tjetër do të hartohet për të gjitha komunat e tjera. Reformimi i pushtetit lokal parasheh delegimin e kompetencave të caktuara nëpër komuna nga pushteti qendror, siç është ujësjellësi, tregjet, trafiku urban, çështjet sociale. Vlerësohet se pilot-njësitë janë duke funksionuar mirë, dhe me kohë pritet të bëhet zyrtarizmi i tyre në komuna. Për këto, dhe të tjera, për "Infopress" flet ministri i Pushtetit Lokal, Sadri Ferati.

Kompetencat e komunave

Infopress: Z. Ministër, a mund të na i thoni prioritetet që do t'i ketë Ministria e Pushtetit Lokal gjatë periudhës në vijim?

Ferati: Përveç pretendimeve tona që të jemi në përfshirjen e të gjitha obligimeve që shtrihen në kuadër të ministrisë sonë, prioriteti i punëve tona do të jetë reformimi i pushtetit lokal, dhe në kuadër të atij reformimi nënkuptohet edhe reformimi i brendshëm i qeverive lokale. Ky do të jetë një proces i vazhdueshëm, ngase edhe shumë vende me traditë shumë më të gjatë të qeverisjes pushtetin lokal e kanë gjithherë në një proces të zhvillimit. Njëkohësisht prioritet tjetër do të jetë edhe decentralizimi, në kuptimin e kompetencave shtesë që duhet të kenë komunat sipas Pakos së Ahtisarit dhe në kuptimin e decentralizimit në rrafshin horizontal, pra krijimin e komunave të reja, jo vetëm 5+1. Në këtë drejtim sfida kryesore do të jetë vetë instalimi i kësaj reforme, por njëkohësisht edhe ngritja e kapaciteteve nëpër komuna, në mënyrë që ato të jenë sa më të gatshme për të pranuar kompetenca të reja në shumë fusha. Parashihet që komunat të kenë kompetenca të shtuara në disa segmente. Ne jemi të gatshëm dhe kemi siguruar edhe mbështetje të donatorëve për të instaluar këto kapacitete dhe për të mundësuar aftësim të personelit dhe të krijimit të kushteve në mënyrë që nesër të mund t'i pranojnë këto kompetenca, për t'u shndërruar në shërbime sa më të mira për qytetarët.

Infopress: Cilat do të jenë këto kompetenca konkretisht?

Ferati: Do të jenë në fushën e shërbimeve publike. Pra, në ujësjellës, aty ku ka ujësjellës komunal do të jetë kompetencë e komunës, aty ku është regional do të jetë një koordinim i punëve me komunat përreth. Pastaj, në rrafshin e menaxhimit të tregjeve, trafikut urban, çështjet sociale. Të gjitha këto janë fusha të cilat tani e tutje do të zbresin në kompetencë të qeverive lokale.

Ligji për Prishtinën

Infopress: Përmendët decentralizimin horizontal. Sipas Planit të Ahtisarit, Mitrovica do të jetë qytet me dy komuna. Është folur se edhe Prishtina do të përbëhet nga dy ose tri komuna. A mund të na flisni më gjerësisht rreth kësaj?

Ferati: Ligji për qytetin e Prishtinës është ndër prioritetet, dhe ne e kemi proceduar në agjendën legjislative në qeveri për vitin 2008, dhe në mbledhjen e fundit ai projektvendim është shndërruar në vendim. Do të punojmë që shumë shpejt të përgatisim ligjin për qytetin e Prishtinës. Ndërsa, njëkohësisht në ligjin për qeverisjen lokale, parashihet që një ligj i veçantë të nxirret edhe për qytetet e tjera ku bën pjesë edhe Mitrovica.

Infopress: Çka do të parashihet një ligj i tillë për Prishtinën, do ta ndante atë në dy-tri komuna?

Ferati: Ai i jep statusin e qytetit dhe pastaj do të jetë e drejtë e komunës që ta organizojë jetën e shërbimeve të qytetarëve edhe në nënjesi të qytetit. Pra, do të jetë e drejtë e qytetit të Prishtinës që të organizohet në më shumë se një komunë, në dy, tri apo aq sa ata parashohin se është e domosdoshme. Por, gjithmonë duke e pasur parasysh edhe refleksionin financiar, sepse gjithçka ka një kosto.

Komunat serbe

Infopress: A keni ndonjë plan për komunat me shumicë serbe, për ta njohur ato autoritetin e Kosovës? Dihet që ato as s'kanë marrë pjesë në zgjedhje.

Ferati: Edhe komunat ekzistuese me shumicë serbe, por edhe komunat e reja që do të formohen, ministria jonë ka për qëllim dhe do të punojë që ato të instalohen, por njëkohësisht të ndihmojë në mënyrë që të aftësohen për të kryer funksionet në kuadër të përgjegjësisë dhe detyrave të veta. Këto komuna janë formuar për nevojat e popullatës serbe dhe natyrisht jemi të bindur se ata do të shohin interesin që të vetëqeverisen. Kjo ka qenë një prej sfidave të dialogut dhe të Planit të Ahtisarit, i cili ka paraparë që të ketë më shumë komuna të reja në meset ku popullata serbe është shumicë, me motivacionin që shoqëria e Kosovës është ende e re dhe ishte një dilemë se si do të mund të funksiononte me një shumicë shqiptare prej 90 për qind, duke pasur parasysh që Kosova është një vend, shtet i ardhshëm, postkonfliktuoz. Dhe ekziston dyshimi se sa janë përmirësuar këto relacione. Kjo ka qenë arsyeja që të parashihen këto komuna për t'iu mundësuar serbëve të qeverisin me veten e tyre. Pra, kjo iu dedikohet nevojave të serbëve dhe s'është diçka që iu imponohet nga ana jonë.

Pilot-njësitë

Infopress: Si janë duke funksionuar pilot-njësitë e reja, Mamusha, Juniku dhe Hani i Elezit?

Ferati: Tani për tani kemi tri pilot-njësi që janë në funksion. Ne vazhdojmë t'i ndihmojmë këto pilot-njësi, dhe informacionet e analizës së fundit tregojnë se atje po bëhen përparime të kënaqshme. Ne do të kishim dëshiruar që të vazhdojë fuqizimi i tyre, në mënyrë që kur të bëhen vlerësimet dhe analizat rreth aftësive që ato t'i afrohen një vendimi për t'u shndërruar në komuna, të jetë e arsyeshme. Ngase, formimi i çdo komune motivin fillestar dhe kryesor e ka që të ofrojë shërbime sa më të mira për qytetarët e atij lokaliteti.

Infopress: Kur pritet të bëhet vlerësimi e ndoshta edhe zyrtarizimi i atyre pilot-njësisë në komuna?

Ferati: Shpejt. Vizioni se cili do të jetë fati i pilot-njësisë do të bëhet shumë shpejt.

Informimi i nevojshëm

Ministri Sadri Ferati: Dihet që Kosova po kalon një moment tejet të rëndësishëm dhe historik. Vetë vendimi që pritet të merret shpejt dhe deklarimi i pavarësisë së saj, me një bindje tonën se edhe do të jetë i pranueshëm prej shumicës së vendeve demokratike, do të jetë edhe një sfidë që edhe një Kosovë e passtatusit do të jetë një dëshmi e pjekurisë së shoqërisë së saj. Prandaj,

mua më vjen mirë dhe dua të falënderoj interesimet tuaja si mjete të informimit. Dëshiroj që bashkëpunimi i ministrisë sonë me ju të jetë i vazhdueshëm, për arsye se vërtet kemi çka t'i informojmë qytetarët, ngase decentralizimi, kompetencat, qeverisja lokale, janë një përvojë e re për komunat tona dhe për popullatën.

Intervistoi
Musli Krasniqi